

## Konflikti mes Kosovës dhe Serbis: A mund të ndihmojë rajoni?

### Hyrje

Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) organizoi me 11 qershor 2020 një telekonferencë për një numër analistësh politikë nga Kosova, Serbia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut lidhur me kontributin e mundshëm që vendet e Ballkanit Perëndimor mund të japin për të ndihmuar në zgjidhjen e konfliktit mes Kosovës dhe Serbis. Diskutimi u fokusua në zhvillimet e fundit rreth dialogut, pasojat e pashmangshme negative të një marrëveshje të shpejtë të përfolur që mund të përfshijë shkëmbime terriore, dhe mbi nevojën që partnerët rajonalë të kuptojnë urgjencën dhe të avokojnë për zgjidhje. Pjesëmarrësit diskutuan mbi ndikimin e SHBA-së dhe BE-së në dialog, gjegjësisht “qasjen sipërfaqësore” të administratës së Trumpit që ta zgjidh konfliktin “thjesht sa për ta reklamuar atë si një rezultat të suksesit të tij” në zgjedhjet presidenciale të nëntorit, dhe qëndrimin e dobët të BE-së që thjesht ka zvarritur procesin deri më tani.

Pjesëmarrësit u pajtuan se konflikti Kosovë-Serbi mbetet një sfidë thelbësore dhe se çfarëdo që të ndodhë në marrëdhëniet bilaterale midis dy vendeve, do të ketë implikime edhe për rajonin. Prandaj, pjesëmarrësit thane se rajoni duhet të jetë aktiv në drejtim të rritjes së vetëdijes nga vendimmarrësit, si dhe nga qendrat e vendimmarrjes ose aktivizmi i shoqërisë civile për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe të parandalojë që “marrëveshje të këqija” të ndodhin para se të jetë tepër vonë. Disa pjesëmarrës pranuan që marrëveshja e keqe e përfolur duhet të shërbejë si një mësim në lidhje me këtë çështje, duke marrë parasysh që shumica e partnerëve rajonalë u aktivizuan dhe u alarmuan vetëm kur ideja e ndryshimit të kufijve u soll në tryezë. Prandaj rajoni duhet të ndajë përvojat e tij në zgjidhjen e konflikteve etnike dhe forcimin e demokracive dhe shoqërive multietnike, të cilat mund të jenë të dobishme për krijimin e një mjedisi të favorshëm si për një marrëveshje ashtu edhe për zbatimin e saj. Ndër përfundimet e diskutimi ishte rëndësia që Prishtina dhe Beogradi të identifikojnë se çfarë ndihme do të kishin nevojë nga rajoni, në mënyrë që fqinjët të mund të japin kontributin e tyre.

Punëtorja është pjesë e një iniciative më të madhe të CIG-ut mbi marrëdhëniet Kosovë-Serbi e mbështetur nga dhe zbatuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrrës. Raporti bazohet në diskutimet e mbajtura sipas Rregullës Chatham House. Ne jemi munduar të jemi të saktë dhe të ekuilibruar në përmbledhjen e diskutimeve dhe kërkojmë mirëkuptimin e pjesëmarrësve, disaktimet e të cilëve mund të mos jenë përmbledhur plotësisht në këtë raport të shkurtë.

### SHBA apo BE apo të dyja?

Nga këndvështrimi i Kosovës, një pjesëmarrës tha se Kosova vazhdon të mbetet në harresë, veçanërisht tani me presionin në rritje nga administrata Trump, përkatësisht i dërguari special Richard Grenell, i cili, shumë thanë, “ka pak përvojë në Ballkan” për të shtyrë përpara një

marrëveshje që mund të përfshijë shkëmbime terriroresh. Grenell ka tërhequr Kosovën me premtime se “qytetarët e saj do të shpërblehen me një perspektivë pozitive ekonomike” pasi të arrihet marrëveshja, pa ofruar detaje në lidhje me këto përfitime ose natyrën e marrëveshjes. Nga ana tjetër, BE aspiron të udhëheqë dialogun, por udhëheqja e tanishme e Kosovës duket se ka pak besim në të. Shumë njerëz janë të befashuar që Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) shkoi deri aty sa të dëmtojë marrëdhëniet e saj me Gjermaninë. “LDK duhet të ketë pasur presion të madh nga Grenell.” Edhe SHBA edhe BE kanë ndikim në Kosovë, por SHBA po bën një punë më të mirë në drejtim të promovimit të fuqisë së vet, thane disa, pavarësisht nga fakti se si rruga përfundimtare e Kosovës si ajo e Serbisë është integrimi në BE.

Në të njëjtën kohë, derisa e konsideruan një mundësi të keqe një marrëveshje të nxituar, disa thanë se mund të ishte gjithashtu një dritare mundësish. Kosova nuk ka perspektivë për anëtarësim në BE ose NATO për shkak të mosmarrëveshjes me Serbinë dhe faktit që ka vende anëtare të BE dhe NATO që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. “Nëse na mungon kjo dritare mundësish, konflikti do të zgjasë me vite,” tha një pjesëmarrës. “E vetmja mundësi tjetër është të bindësh disi jo-njohësit për të ndryshuar mendimin e tyre, por kjo nuk ka gjasa të ndodhë pa njohjen e Serbisë.”

Një pjesëmarrës tha se Kosova është dëshmitare e ndryshimit të qëndrimit amerikane ndaj Kosovës për shkak të Trumpit. Megjithatë, lidhja që ekziston midis Kosovës dhe SHBA është vështirë për t’u dëmtuar dhe, për këtë arsye, shumë argumentuan se “për kosovarët është e vështirë t’i thonë jo mikut të tyre historik.” Një pjesëmarrës tjetër shtoi se kosovarët i besojnë SHBA sepse ajo asnjëherë nuk ka dështuar t’i ndihmojë ata.” Vetëm vitin e kaluar ajo ndihmoi në krijimin e ushtrisë së Kosovës, përkundër rezervave të BE-së. BE, nga ana tjetër, “më së shumti që ka ndihmuar Kosovën është nënshkrimi i marrëveshjes së MSA-së.” BE nuk ka arritur të përmbushë dëshirën më të madhe të qytetarëve kosovarë—liberalizimin e vizave—duke shkaktuar zhgënjim të madh tek popullata e izoluar, e vetmja që mbetet pa viza në Evropë.

Nga këndvështrimi i Serbisë, procesi i normalizimit është me interes të ndërsjellë për të dy vendet. Pjesëmarrësit shprehën kritika të forta drejt BE-së. BE ka qenë e pranishme në Ballkanin Perëndimor në shumë dimensione, veçanërisht në Kosovë dhe Serbi. Sidoqoftë, qasja e saj e kushtëzuar ndaj procesit të ndërtimit të shtetit ka treguar të jetë joefektive për shkak të arsyeve vijuese: mungesa e përkushtimit të elitave politike për integrimin në BE, mungesa e politikës së zgjerimit të BE-së dhe çështja e statusit të pazgjidhur për shkak të pozicionit të ndarë mbi Kosovën brenda BE-së. E gjithë kjo ka pasur një efekt paralizues në proceset politike. Një pjesëmarrës identifikoi dy skenarë të mundshëm, një duke përfshirë një njohje implicite me krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe—një lloj modeli të autonomies—ku Kosova bëhet anëtare e KB. Dhe e dyta me një korigjim të kufijve dhe një njohje e qartë midis dy vendeve. Skenari i parë ofron rezultate modeste sepse a) SHBA kërkon një zgjidhje të përhershme, por me një afat kohor të kufizuar nuk ka kohë të mjaftueshme për pajtim; b) distanca etnike midis serbëve dhe shqiptarëve mbizotëron pajtimin; c) Presidenti serb Aleksandar Vucic dhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje të cilën do ta cilësonin si fitore kombëtare.

Sidoqoftë, ideja për korigjimin e kufijve është e rrezikshme dhe, në të vërtetë, ajo do të hapte kutinë e Pandorës. Partnerët rajonalë e kanë pranuar këtë rrezik, pasojat e të cilit do të kishin ndikim edhe në çështjet e tyre të brendshme. Kjo është arsyeja pse përfshirja e tyre është e

nevojshme, dhe çfarëdo marrëveshje që arrihet midis Beogradit dhe Prishtinës duhet të ketë edhe pëlqimin e fqinjëve të Ballkanit Perëndimor.

## **Çka mund të bëjë rajoni për të ndihmuar?**

Së pari, rajoni duhet të kuptojë urgjencën dhe nevojën për një zgjidhje, theksoi një pjesëmarrës. Së dyti, duhet të ketë një përmirësim të marrëdhënieve dhe ndërtimit të besimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për shembull, Vuçiç nuk ka besim në disa vende të rajonit, ngase ata i janë ankuar kancelares gjermane për mosgatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me ta. Kjo është arsyeja pse ai është afruar me disa miqë të tij të vjetër në rajon e më gjerë, si me kryeministrin e Hungarisë Viktor Orban. Kosova, në anën tjetër, ka dëmtuar marrëdhëniet madje edhe me Shqipërinë për shkak të përfshirjes së kryeministrit Edi Rama në iniciativën Minishengen dhe mospërfshirjen e Kosovës në të. Ideja e shkëmbimit të territoreve po mbizotëron diskutimet mbi një marrëveshje Kosovë-Serbi. Nëse do të ndodhë, implikimet serioze negative rajonale janë të pashmangshme. Kjo është arsyeja pse rajoni duhet të mbështet një zgjidhje që nuk përfshin ndryshimet e kufijve.

Një pjesëmarrës tjetër nga Serbia tha se rajoni duhet të përdorë një gjuhë të një dialogu që mundëson normalizimin edhe midis shoqërive. “Procesi i normalizimit nuk duhet të jetë vetëm për dy burrat e gjithëfuqishëm, por edhe për njerëzit e zakonshëm.” Regjioni duhet të mbështesë çdo lloj marrëveshje për të cilën pajtohen Kosova dhe Serbia në dy kushte, a) marrëveshja përjashton dhunën jo vetëm midis dy shteteve, por edhe brenda tyre; b) mbron të drejtat e minoriteteve dhe garanton mbrojtje për ta. Pësia e ndryshme e fqinjëve të ndryshëm gjithashtu duhet të merret në konsideratë, p.sh. Shqipëria duhet të jetë e kujdesshme të mos flasë në terma etnikë, por më tepër për marrëdhëniet midis njerëzve. Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut gjithashtu mund të udhëheqin me shembuj dhe ta zbusin perceptimin se serbët janë nën kërcënim.

Një folës tha që në të vërtetë ishte Bosnje dhe Hercegovina që shpiki së pari modelin e një marrëveshje të tillë dhe po shërben si një shembull i një demokracie të dështuar. Kur bëhet fjalë për ndihmën e nevojshme nga rajoni, duhet të jenë ekspertë dhe analistë që mund të bëjnë përpjekje shtesë dhe urgjente për të rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje për SHBA dhe BE. Politikanët duhet të qëndrojnë jashtë kësaj sepse ata do të komplikojnë çështjet edhe më tepër. Sidoqoftë, duhet të shihet elementi i mundshëm pozitiv i një marrëveshje të mirë që krijon një rrjet komunikimi në mënyrë që Beogradi dhe Prishtina të kenë bisedime të hapura që do të çonin tek një zgjidhje.

Pjesëmarrësi përmendi gjithashtu ndikim të mundshëm shtesë të huaj si Rusia. Vucic do të takohet me presidentin rus Vladimir Putin pas zgjedhjeve serbe të 21 qershorit dhe ka shumë të ngjarë që një marrëveshje e mundshme me Kosovën të jetë pjesë e diskutimit të tyre. “Ndikimi shtesë i huaj do të hedh karburant në zjarrin lokal.” Në mungesë të BE-së, Ballkani do të gjendet në sferat e ndikimit të Ruisë, Turqisë dhe Kinës, dhe ekziston mundësia që të ketë ndarje në Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe në rajonin e Sanxhakut të Serbisë.

Pjesëmarrësit e tjerë ishin të shqetësuar për pasojat e mundshme rajonale të një ‘marrëveshje të keqe Kosovë-Serbi’. Një folës u pajtua që implikimet rajonale duhet të vendosen në tryezë, dhe që pëlqimi i fqinjëve është i rëndësishëm, por ata nuk duhet të mbahen peng nga njëri-tjetri për shkak të marrëdhënieve individuale me Kosovën ose Serbinë. Shqipëria mund të jetë konstruktive por jo neutrale. Kjo do të thotë, Tirana as nuk mund ta injorojë Prishtinën dhe as

të mbahet peng i marrëdhënieve të përditshme me Beogradin. Pozicioni i Tiranës për momentin është neutral, dhe kjo për faktin se nuk dëshiron të kënaqet as nga Washingtoni e as nga Berlioni. Sidoqoftë, Shqipëria ndan të njëjtën dëshirë si partnerët rajonalë për dëshirën e mbylljes së këtij kapitulli.

Një pjesëmarrës theksoi se rajoni nuk mund të interesohet për këtë çështje më shumë sesa vet qytetarët e Kosovës dhe Serbisë. “Nëse ata vërtet duan një marrëveshje të keqe, le ta bëjnë.” Ideja e ndryshimit të kufijve mund të rihapë çështjet e pakicave në Maqedoninë Veriore. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut nuk do të donin të hynin në “procese të rrezikshme dhe të prishin pozicionin e tyre të përmirësuar në vend, por gjithmonë ekzistojnë elementë thelbësorë që e shohin atë si një dritare të mundësive.” Duke pasur parasysh përvojën e Maqedonisë së Veriut me Greqinë, folësi deklaroi se është e rëndësishme të zgjidhni kohën dhe momentin e duhur.

Një shkëmbim territoresh nuk ka të ngjarë të ndodhë pa një shkëmbim të popullatës. Një pjesëmarrës parashikoi që njerëzit do të lëvizin vullnetarisht ose në mënyrë të pavullnetshme nga shtëpitë e tyre në “anën e duhur të kufirit”. Sidoqoftë, folësi nuk parashikoi ndonjë konflikt serioz. Ka elita që po bëjnë zhurmë për konfliktin, dhe me elita të tilla, nuk ka një të ardhme të ndritshme për rajonin, por “nuk ka asnjë potencial as për dhunë të përtërirë”.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Pjesëmarrësit identifikuan një numër sugjerimesh dhe rekomandimesh.

- Regjioni duhet të rrisë ndërgjegjësimin se konflikti Kosovë-Serbi është një çështje bilaterale, rajonale dhe evropiane dhe kërkon përfshirjen e të gjithë këtyre palëve të interesuara.
- Nëse ka hartime të një marrëveshje, ato duhet të diskutohen para nënshkrimit, në mënyrë që të shmangin konfliktet rajonale. Ndërsa një marrëveshje mund të zgjidhë konfliktin Kosovë-Serbi, por të hapë konflikte në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoninë e Veriut.
- Një marrëveshje përfundimtare duhet të përfshijë jo vetëm nënshkrimin e Prishtinës dhe Beogradit, por edhe miratimin nga rajoni.
- Një marrëveshje përfundimtare duhet të përfshijë një komponent “të merresh me të kaluarën.”
- Një marrëveshje përfundimtare duhet të rikonfirmojë të drejtat e pakicave.
- Organizatat e shoqërisë civile në rajon duhet të bëjnë presion mbi palët e interesuara dhe të promovojnë një marrëveshje që u sjell dobi qytetarëve dhe jo individëve.
- Prioriteti strategjik i rajonit duhet të mbetet integrimi në BE dhe normalizimi midis vendet e rajonit
- Rajoni duhet të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për një marrëveshje dhe të saj implementimi përmes një seri iniciativash zyrtare dhe joformale.
- BE duhet të japë premtimin e saj të gjatë për liberalizimin e vizave në Kosovë dhe të bëjë e ardhmja e BE-së e prekshme për vendin.

## **Pjesëmarrësit**

**Donika Emini  
Shpetim Gashi  
Ismet Hajdari  
Una Hajdari  
Vincent Hug  
Remzi Lani  
Srecko Latal  
Sonja Licht  
Jeta Loshaj**

**Agon Maliqi  
Zoran Necev  
Igor Novakovic  
Natasa Petrovic  
Jovana Radosavljevic  
Alex Roinishvili Grigorev  
Marko Savkovic  
Sonja Stojanovic Gajic  
Stefan Surlic**